



**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA**

---

Numri i lëndës: 2019:270544

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05813913

KA.nr.254/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “New Co Ferronikeli Complex” L.L.C., me NRB: 70268073 me seli në Drenas , Rr. “Ferronikeli”, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, me seli në Prishtinë, për shkak të plotësimit të Vendimit Nr.19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, ne rivendosje më datë 30.05.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **HEDHET poshtë padia** e paditësit “New Co Ferronikeli Complex” L.L.C. me seli në Drenas, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë me seli në Prishtinë, për shkak të plotësimit të Vendimit me Nr.19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, e parashtruar pas kalimit te afatit.
  
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Historiku procedural

1. Me datë 20.11.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative, “NewCo Ferronikeli Complex” L.L.C., me seli në Drenas, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.2756/2019, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, me seli në Prishtinë, për shkak të plotësimit të Vendimit Nr.19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, të nxjerr nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, me propozim që pjesa e Vërejtjes së dhënë në faqen e 3 të aktit administrativ të largohet në tërësi.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 289/22.
3. Pas seancës përgatitore të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur më datë 17.11.2023, në mungesë të përfaqësuesit të paditësit avokat Blerim Prestreshi sipas autorizimit të datës 27.07.2017 i cili e ka pranuar ftesën për në seancë më datë 17.10.2023, ftesës nuk i është përgjigjur, mungesën nuk e ka arsyetuar dhe në prezencë të përfaqësuesit të palës së paditur, Avokat Zyle Millaku Gojnovci nga Avokatura Shtetërore sipas autorizimit të datës 16.11.2023, gjykata marr Aktgjykim me datë 30.11.2023.
4. Pas marrjes se Aktgjykimi u konstatua se paditësi me date 14.11.2023 kishte parashtruar kërkesë për tërheqje të padisë, mirëpo me rastin e mbajtjes së seancës parashtrësia nuk ishte e vendosur në shkresat e lëndës.
5. Paditësi ndaj Aktgjykimit të datës 14.11.2024 kishte parashtruar ankesë, e cila është aprovuar me Aktvendim të Dhomave të Shkallës së dytë K.DH.SH.II. 560/24 dhe lënda është kthyer në rivendosje. Në rivendosje lënda ka marrë nr. KA. 254/24.

#### Pretendimet e paditësit

6. Përfaqësuesi i paditësit në padi ka deklaruar se, me vendimin Nr. 19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, e paditura ka aprovuar kërkesën e paditësit “NewCo Ferronikeli Complex” L.L.C., për Pëlqim Mjedisor për përdorimin e materialit RDF në furrat rrotulluese të paditësit. Vendimi i lëshuar nga e paditura përmban disa kushte që duhet ti plotësoj paditësi. Ndër të tjera, si kusht që duhet plotësuar është edhe ruajtja dhe magazinimi i mbetjeve RDF sipas kodeve (19 12 12 dhe 19 05 01), të monitorohet dhe të mos pranohet formë tjetër e paketimit të materialit RDF, ndërsa si vërejtje që është dhënë në këtë vendim është se paditësi duhet të ketë parasysh se sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht UA 02/2019 për eksport, import dhe kalimit transit të mbeturinave neni 13 par.2 ndalon importin e mbeturinave të parrezikshme për qëllime deponimi dhe djegje në rastin konkret edhe të RDF, ku ky nen e përjashton RDF vendore që mund të shfrytëzohet si lëndë djegëse.
  
7. Ka deklaruar se kërkesa e paditësit ka të bëjë pikërisht me materialin RDF që do të përdoret në furrat rrotulluese. E paditura e ka të njohur faktin se ky material nuk është prodhim vendor dhe se i njëjti duhet të importohet nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, duke qenë se ky material nuk gjendet në tregun e brendshëm por vetëm nga importi, atëherë vërejtja që përmban ky vendim është në kundërtënie me kushtet që duhet plotësuar nga paditësi dhe është kundërtënjese kur në një anë paditëset i jepet pëlqimi për përdorim të materialit RDF dhe i jepet si kusht ruajtja dhe magazinimi i mbetjeve RSF që të bëhet monitorimi konstant i tyre, kurse në anën tjetër në pjesën e vërejtjes, të konstatohet se ndalohej importi i këtij materiali. Duke qenë se kjo ka ardhur si rezultat i keqinterpretimit të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nga ana e të paditurës. I ka propozuar gjykatës që të aprovohej padia e paditësit “NewCo Ferronikeli Complex” L.L.C., me seli në Prishtinë dhe të plotësohet Vendimi Nr.19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, të nxjerr nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, me propozim që pjesa e Vërejtjes së dhënë në faqen e 3 të aktit administrativ të largohet në tërësi.

#### Kundërshtimet e të paditurës

8. Përfaqësuesi sipas autorizimit i palës së paditur në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi ka deklaruar se, e paditura e kundërshton në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit për Plotësim të Vendimit me Nr. 19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, pasi që vendimi është nxjerrë konform dispozitave ligjore të nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit neni 22 dhe 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe neni 13 par.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 për Eksport, Import, dhe Kalimit Tranzit të Mbeturinave.
9. Ka deklaruar se e kanë shqyrtuar kërkesën e paditësit për përdorimin e materialit RDF në furra rrotulluese, në parcelën kadastrale Nr.P-... në vendin e quajtur “Kriçesta”, Zona Kadastrale Çikatove e re dhe mbi këtë bazë ka aprovuar kërkesën e kompanisë/paditësit për pëlqimin Mjedisore për përdorimin e materialit RDF në furra rrotulluese, nën kushtet për zbatim të vendimit siç përcakton ligji, respektivisht arsyetimi i vendimit të atakuar me padi është nxjerrë konform nenit 22 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, andaj pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara me asnjë provë se aktit administrativ ti plotësohet pjesa në faqen 3 të arsyetimit pasi që si e tillë arsyetimi është konform ligjit dhe dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 për Eksport, Import, dhe Kalimit Tranzit të Mbeturinave dhe duke u bazuar në kompetencën dhe përgjegjësinë e paditësit si dhe akti administrativ është i nxjerrë konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si i ligjshëm andaj i padituri në mënyre të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike në procedurën administrative.
10. Për më tepër paditësi më datë 17.10.2019 ka pranuar Vendimin nr. 19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë kundër të cilit më datë 20.11.2019 ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Administrative, ku mbi këtë bazë paditësi e ka parashtruar padinë jashtë afatit ligjorë të Ligjit për Konfliktet Administrative, respektivisht sipas nenit 27 ku përcakton se *“Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë*

*padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti*". Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të hudhet poshtë si e pa lejuar, pasi që është e parashtruar jashtë afatit ligjorë.

### Vlerësimi i gjykatës

11. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në padi dhe kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, Gjykata vlerësoi pretendimet e të paditurës së padia është parashtruar pas afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës Gjykata vlerëson se me vendimin Nr. 19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, e paditura ka aprovuar kërkesën e paditësit "NewCo Ferronikeli Complex" L.L.C., për Pëlqim Mjedisor për përdorimin e materialit RDF në furrat rrotulluese të paditësit. Paditësi më datë 17.10.2019 ka pranuar Vendimin nr. 19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Në Dergesë drejtuar paditësit "Newco Ferronikeli Complex LLC, është nënshkruar pranimi nga I.N.. Kundër këtij vendimi më datë 20.11.2019 ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë.

12. Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-202 Për Konfliktet Administrative neni 26 përcakton se , procedurën në bazë të padisë, ku paragrafi 1 specifikon se: 1. *Konflikti administrativ fillohet me padi* 2. *Me padi mund të kërkohet: 2.1. anulimi ose shpallja e pavlefshme e aktit kontestues; 2.2. nxjerrja e aktit administrativ, i cili nuk është nxjerrur në afatin e parashikuar; dhe 2.3. kthimi i sendeve të marrura dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar*, ndërsa neni 27 përcakton se: *Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti*. Andaj duke e pasur parasysh faktin se Ministria e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinorë vendimin kontestues Nr.19/4114/2-ZSP/481/19 të datës 08.10.2019, paditësi e ka pranuar me datë 17.10.2019, ndërsa padinë kundër këtij vendimi kontestues e ka paraqitur më datë 20.11.2019, e cila datë vërtetohet nga shkesa e zyrës së pranimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, gjykata erdhi në përfundim se padita e paditësit është e pasafatshme.

13. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 34 paragrafi 1.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.254/24, datë 30.05.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.